

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE TË REVIZIONUARA (REV.2.1)”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka si qëllim miratimin e “Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2.1)”, me qëllim harmonizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.

Objektivi që synohet të arrihet është sigurimi i kuadrit për mbledhjen dhe paraqitjen e një game të gjerë të dhënash statistikore sipas aktiviteteve ekonomike në fushat e statistikave ekonomike (p.sh. prodhimi, punësimi, llogaritë kombëtare) dhe në fusha të tjera statistikore. Statistikat e prodhuara në bazë të klasifikimit NACE janë të krahasueshme në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti është detyrim që lind nga zbatimi i nenit 24 të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, i cili ngarkon Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën të kryejë përditësimin dhe përshtatjen e klasifikimeve statistikore, ekonomike dhe sociale, në përputhje me klasifikimet statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Parashikimet ligjore kanë realizuar angazhimin e qeverisë shqiptare për përmirësimin e treguesve statistikorë zyrtarë të prodhuar nga Sistemi Kombëtar Statistikor dhe rritjen e imazhit të INSTAT-it e të besueshmërisë së përdoruesve në statistikat zyrtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i projektaktit “Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1)” është hartuar nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën për t’i shërbyer qëllimeve të ndryshme statistikore, dhe zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë ekonomike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1) është përshtatur sipas klasifikimit evropian NACE Rev 2.1, i cili zbatohet nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Projektvendimi nuk parashikohet të sjellë problematika, ndërkohë që efekti kryesor i pritshëm është rritja e cilësisë statistikore dhe krahasimi i tyre në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUETSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi paraqitet si propozim i Kryeministrit, në mbështetje të:

- a) ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- b) pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”;
- c) Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektakt ka një përputhshmëri të pjesshme me Rregulloren e Deleguar të Komisionit Evropian Nr. 2023/137, datë 10.10.2022 “Mbi ndryshimin e Rregullores nr. 1893/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që themelon klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Revision 2”.

Ky projektakt është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, për miratim nga Këshilli i Ministrave.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pika 1 e projektvendimit përcakton zbatimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1) ku përcaktohet kodifikimi i mallrave sipas Rregullores së Deleguar të Komisionit Evropian Nr. 2023/137, datë 10.10.2022 “Mbi ndryshimin e Rregullores nr. 1893/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që themelon klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Revision 2”, të miratuar paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën.

Pika 2 e projektvendimit përcakton fushat në të cilat zbatohet Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1), e njohur shkurtimisht “NVE Rev.2.1”.

Pika 3 e projektvendimit parashikon institucionet të cilat do të zbatojnë Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1).

Pika 4 e projektvendimit përcakton zëvendësimin e kodeve statistikore të veprimtarive ekonomike të përdorura deri më tani, me kodet e parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1).

Pika 5 përcakton vitin 2025 si periudhë tranzitore për marrjen e masave përgatitore për implementimin e klasifikimeve të reja të miratuara nëpërmjet këtij vendimi.

Pika 6 ngarkon Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit të bëjë integrimin e klasifikimeve të reja gjatë periudhës tranzitore.

Pika 7 ngarkon institucionet dhe subjektet e tjera për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (Rev.2.1).

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e projektaktit janë të gjithë institucionet publike të përmendura në pikën 3 të projektvendimit.

Institucioni përgjegjës që ngarkohet me monitorimin dhe zbatimin e aktit është Instituti i Statistikave dhe Komisioni Kombëtar për Nomenklaturat.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e projektaktit kanë kontribuar punonjësit e INSTAT si dhe anëtarët e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk parashikohet të sjellë efekte financiare për buxhetin e shtetit.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA